



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2

Dhjetor 2024

ROLI I MËSUESIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR NË MËSIMIN E GJUHËS LETRARE SHQIPE-DETYRË JO VETËM INSTITUCIONALE POR EDHE KOMBËTARE

Esmeralda Strori*

**Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University*

Përmbledhje

Qëllimi i këtij punimi shkencor është të rivlerësojë rolin që ka mësuesi i arsimit parashkollor në mësimin e gjuhës letrare shqipe. Pas viteve 90, për shkak të tranzicionit, të emigrimit dhe migrimit të popullsisë, mosrespektimit të ligjit mbi gjuhën standarde shqipe, situata gjuhësore është bërë kaotike. Nuk janë të pakta rastet kur brenda një situatë ligjërimore ndeshim fjalë dialektore, fjalë krahinore, fjalë të huaja të panevojshme por edhe ndërtime sintaksore që nuk i përkasin gjuhës standarde shqipe. Nuk janë të pakta edhe rastet kur fëmijët e arsimit parashkollor shumë fjalë shqipe i zëvendësojnë me fjalë të huaja, si p.sh: ciao apo bye bye për mirupafshim; ok për në rregull; hello për përshëndetje; good morning për mirëmëngjes etj. (Shkurtaç. Gj, 2015)

Në kushte të tilla mësuesi i arsimit parashkollor ka për detyrë të tregojë profesionalizëm mbi ruajtjen dhe përdorimin e gjuhës standarde shqipe, si një detyrë jo vetëm institucionale dhe kulturore por edhe kombëtare. Si rezultat ky punim shkencor kërkon të vërë në dukje domosdoshmërinë e njohjes së gjuhës standarde shqipe dhe rritjes së kujdesit të përdorimit të saj (si gjuhë e folur dhe e shkruar) tek mësuesit e arsimit parashkollor të cilit ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e vetëdijes gjuhësore tek fëmijët e moshave të vogla. Metodatat e përdorura në këtë punim shkencor janë: induksioni, deduksioni, vëzhgimi, analiza përshkruese.

Fjalë çelës: *gjuha letrare shqipe, fjalë dialektore, fjalë krahinore, fjalë të huaja, rivlerësim, vetëdije gjuhësore, detyrë kombëtare.*

THE ROLE OF THE PRE-SCHOOL TEACHER IN LEARNING ALBANIAN LITERARY LANGUAGE - NOT ONLY INSTITUTIONAL BUT ALSO NATIONAL TASKS

Abstract

The purpose of this scientific paper is to reevaluate the role of the preschool teacher in learning the

Albanian literary language. After the 90s, due to the transition, emigration and migration of the population, non-respect of the law on the standard Albanian language, the linguistic situation became chaotic. There are not a few cases when, within a legislative situation, we come across dialect words, provincial words, unnecessary foreign words, but also syntactic constructions that do not belong to the standard Albanian language. There are not a few cases when preschool children replace many Albanian words with foreign words, such as: ciao or bye bye for mirupafshim; ok for në rregull; hello for përshëndetje; good morning for mirëmëngjes etc. (Shkurtaç. Gj, 2015)

In such conditions, the pre-school teacher has the duty to show professionalism in the preservation and use of the standard Albanian language, as a duty not only institutional and cultural but also national. As a result, this scientific paper seeks to point out the necessity of knowing the standard Albanian language and increasing the care of its use (as a spoken and written language) among preschool teachers, which directly affect the development of language awareness in children of small ages. The methods used in this scientific paper are: induction, deduction, observation, descriptive analysis.

Key words: *Albanian literary language, dialectal words, provincial words, foreign words, re-evaluation, linguistic awareness, national duty.*

Hyrje

Për fat të keq pas viteve 90-të, për shkak të ndryshimit të sistemit politik, emigrimit dhe migrimit të popullsisë, por edhe nën ndikimin e globalizmit disiplina gjuhësore shqiptare ka qenë në rënie. Arsyet janë nga më të ndryshmet që nga mungesa e dijes, futja e mjeteve të teknologjisë së informacionit, mosrespektimi i rregullave drejtshkrimore e drejtshqiptimore të gjuhës shqipe standarde, pse jo edhe dhënia rëndësi më tepër seç duhet gjuhës së huaj dhe nënvlerësimi i gjuhës amtare dhe kulturës kombëtare në tërësinë e saj. Fjalët e huaja të panevojshme, veçanërisht ato që vijnë nga fusha e teknologjisë gjithnjë e më shumë janë të pranishme. Përmendim këtu: abandonoj për braktis; abdominal për barkor; abort për dështim; absorboj për përthith; apdejtoj për përditësoj; amplifikator për përforcues; sevoj për ruaj; daunludoj për shkarkoj etj. Fjalë të tilla për shkak të përdorimit të dendur të tyre sillen sikur të jenë të gjuhës shqipe. Një situatë e tillë i ka vënë gjuhëtarët përballë shqetësimit të madh të ruajtjes së gjuhës standarde shqipe qoftë prej dialektizmave, krahinorizmave, qoftë prej fjalëve të huaja. Prof. Gjovalin Shkurtaç në veprën e tij “Urgjenca gjuhësore”, Tiranë 2015, që në titull i bie këmbanës së alarmit mbi ruajtjen dhe kujdesin e gjuhës kombëtare. Ai shprehet se: “Shteti dhe strukturat institucionale, që drejtojnë arsimin, shkencën, artin etj., duhet të jenë më të ndjeshëm ndaj problemeve dhe shqetësimeve të gjuhësisë shqiptare dhe të marrin masa dhe nisma për ta mbrojtur gjuhën shqipe. Gjuha është tipar themelor i kombit shqiptar, prandaj atë duhet ta ruajmë dhe ta mbrojmë, ta shkruajmë e ta flasim sa më thjesht e sa më bukur.” (Gjovalin Shkurtaç “Urgjenca gjuhësore”, Tiranë, 2015). Ashtu si në Europën e qytetëruar, ruajtja, mbrojtja dhe masat për lëvrimin e pastrimin e gjuhës dhe kujdesin e organizuar e të drejtuar nga shteti dhe nga institucionet që varen prej tij.

Analizë Teorike

Vëmendja ndaj gjuhës duhet të nisë që prej arsimit parashkollor, moshë në të cilën zhvillohet vetëdija gjuhësore, dhe jo vetëm, por edhe aftësia për të dialoguar dhe për të bërë pyetje dhe dhënë përgjigje të sakta. “Fëmijët e mësojnë gjuhën nëpërmjet imitimit apo sipas një modeli që i nden asaj bashkësia shoqërore ku lind e rritet, dhe jo si trashëgimi apo produkt gjenetik. Vetëm predispozicioni i organeve të folurit të fëmijës për veprimtari folëse është gjenetik.” (Gjovalin Shkurtaç “Sociolinguistika”, Tiranë, 2003). Aftësia për ta përvetësuar gjuhën është e lindur, ndërsa më tej ajo kultivohet në mjediset ku një fëmijë kalon kohën e tij. Në këtë kuptim roli i mësuesit të arsimit parashkollor për mësimin e gjuhës standarde shqipe ka një vend të veçantë. Ai përcjell tek fëmijët sigurinë mbi mësimin e gjuhës, është rregullator gjuhësor. I referohem pikërisht arsimit parashkollor pasi në këtë moshë, pasi mbush

3 vjeç fëmijët zakonisht shkojnë në kopsht. Në arsimin parashkollor bëhet punë e programuar dhe e organizuar mësimore dhe edukative. “Programi i edukimit të fëmijëve në kopshte parashikon zhvillimin e të gjitha anëve të gjuhës së folur: të fjalorit, sistemit gramatikor dhe të shqiptimit të tingujve. Sipas moshave, bëhet edhe ndarja e fëmijëve në grupe, gjë që jep mundësi që edhe ngarkesa e trurit të fëmijës të ndjekë pikërisht një shkallë ngjitëse, derisa të arrihet në përvetësimin e plotë të gjuhës.”, (Gjovalin Shkurtaj “Sociolinguistika”, Tiranë, 2003). Ndarja e fëmijëve në grupe bëhet sipas moshës së tyre. Nga studimet e shumta mbi gjuhën e fëmijëve mendohet se deri në moshën dy vjeç fëmijët përvetësojnë nga 250-300 fjalë, në moshën 3 vjeç nga 800 deri në 1000 fjalë. Me rritjen në moshë fjalori i tij vjen e zgjerohet, tashmë edhe duke përdorur fjali të shkurtra, fraza më të plota derisa në fund të arsimit parashkollor mendohet që regjistri i tij të shkojë deri në 3600 njësi leksikore, kjo në varësi të mjedisit shoqëror ku fëmija rritet e edukohet. Në këtë periudhë moshore fillon rrezatoni një qëndrim kritik i fëmijës si në drejtim të gjuhës së tij ashtu edhe në drejtim të gjuhës së moshatarëve të tij apo të rriturve. Në mjediset e kopshteve nuk janë të pakta rastet e përdorimit të dialektalizmave, krahinorizmave (p.sh., syni për syri; nana për nëna; rana për rëra etj), të fjalëve të huaja, kryesisht anglicizmave dhe italianizmave; shpeshherë fëmijët thonë ciao në vend të mirupafshim, bye-bye në vend të mirupafshim, ok në rregull, goodmorning për mirëmengjes, hi, hello, etj., (kjo nuk do të thotë aspak përjashtimin e mësimin të gjuhëve të huaja). Pikërisht detyra e mësuesit të arsimit parashkollor është të zbardhë këtë mjegullnajë shqipanglishtitalishteje (siç e quan profesor Edmond Tupja) duke qenë vetë modeli; që do të thotë në kontekstin e duhur të përdoret gjuha e duhur; në mënyrë që fëmijët të mos bien pre e një situatë kaotike dhe mjegullfolëse. Gjuha standarde shqipe shërben si rregullator i komunikimit në një bashkësi folëse, konkretisht në arsimin parashkollor ajo bashkon fëmijë të trevave të ndryshme, shuan diferencat mes tyre dhe thjeshton bashkëbisedimin dhe dialogun. Kjo nuk do të thotë që mësimi i gjuhëve të huaja të përjashtohet në arsimin parashkollor por përdorimi i tyre duhet bërë në kontekstin e duhur. Pra diferencimi i gjuhëve të ndryshme tek fëmijët e arsimit parashkollor duke pasur si model gjuhën standarde shqipe u jep siguri edhe për t’i përvetësuar më drejt gjuhët e tjera.

Si rrjedhim mësuesit të arsimit parashkollor i del për detyrë të jetë njohës i mirë i gjuhës standarde shqipe, i qartë për dallimet midis gjuhës standarde shqipe, fjalëve dialektore, krahinorizmave apo ndikimeve të huaja. Nuk janë të pakta gabimet drejtshkrimore e drejtshqiptimore (përfshirë edhe theksin dhe vendosjen e saktë të tij në fjalë) që gjenden tek mësuesit e arsimit parashkollor.

Përfundime

Mësuesit e arsimit parashkollor, qofshin këta edhe studentë të fushës së edukimit të tregojnë kujdes mbi përdorimin e gjuhës standarde shqipe.

- Të respektojnë rregullat drejtshqiptimore të gjuhës shqipe.
- Të respektojnë rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe.
- Të shmangin përdorimin e fjalëve të huaja krejt të panevojshme.
- Të dallojnë termin ndërkombëtar, të shprehur në gjuhë të huaj nga fjalët e huaja të panevojshme.
- Të shmangë përdorimin e dialektizmave dhe krahinorizmave që vetëm mund të vështirësojnë situatën gjuhësore.
- Të ketë të qartë dallimet gjuhësore mes dialekteve të shqipes.
- Të kuptojnë që dialektet janë pasuri e një gjuhe, dhe jo varfëri, por përdorimi i tyre bëhet brenda një konteksti të caktuar.
- Të përditësojë fjalorin gjuhësor me fjalë të reja (neologjizma) që hyjnë në gjuhën shqipe.
- Të përdorë drejt terminologjinë e fushës së edukimit.

Rekomandime

Nga pikëpamja institucionale, por edhe nga kujdesi dhe ndjeshmëria mbi përdorimin e gjuhës norma-

tive lindin disa detyra:

- Pedagogët e universiteteve (veçanërisht të fushës së edukimit, ku problemi është më i ndjeshëm) të tregojnë kujdes mbi përdorimin e gjuhës së folur dhe të shkruar standarde shqipe.
- Në kurrikulat e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes t'i jepet më tepër peshë disiplinave gjuhësore dhe letrare.
- Të organizohen aktivitete institucionale që nxisin leximin në gjuhën amtare (leksione të hapura, takime me gjuhëtarë të rëndësishëm shqiptarë etj.).

Literaturë

1. Rami Memushaj, “Gjuha standarde-Si ta flasim dhe shkruajmë?”, Tiranë, 2002.
2. Gjovalin Shkurtaç, “Sociolinguistika”, Tiranë, 2003.
3. Gjovalin Shkurtaç, “Si të shkruajmë shqip”, Tiranë, 2013.
4. Gjovalin Shkurtaç, “Urgjenca gjuhësore”, Tiranë, 2015.
5. Gjovalin Shkurtaç, Meleq Shopi, “Gjuha, ligjërimi dhe jeta”, Tiranë, 2018.
6. Xhevat Lloshi, ‘Nga gjuha e normuar prej Kongresit të Drejtshkrimit 1972 te një anarki gjuhësore, “Gjuha shqipe” 1-2017, IAP’.
7. <https://www.youtube.com/watch?v=c4dnqPUTS-s>
8. https://www.google.com/search?q=valter+memisha+per+gjuhen+standarde&rlz=1C1GCEA_enAL1081AL1081&oq=valter+memisha+per+gjuhen+standarde&gs_lcrp=EgZjaHJvbWUyBggAEEUYOTIKCAEQABiABBiiBDIKCAIQABiABBiiBNIBCTExNzI4ajBqOagCALACAQ&sourceid=chrome&ie=UTF-8#